



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 32  
Prishtinë, 24 shkurt 2009, ora 11: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.  
Mungoi: Slllobodan Petroviq

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati,

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Nga KDI: Fitore Zeneli

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

*Komisioni i zhvilloi punimet me këtë*

**REND DITE**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Miratimi i procesverbalit i dëgjimit publik lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të grupit të punës lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi;**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Teuta Hadri** - Lidhur me rendin e ditës tha, meqenëse pika e tretë dhe e katërta kanë të njëjtën tematikë këto dy pika është dashur të bashkoheshin në një pikë të vetme të rendit të ditës.

**Sadik Idriz** – Tha se, pikat tre dhe katër të rendit të ditës duhet të trajtohen ndaras, edhe pse kanë për bazë të njëjtën çështje. Pika e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me miratimin procesverbalit të dëgjimit publik dhe kjo duhet të trajtohet ndaras nga shqyrtimi i raportit të grupit të punës lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi, sepse ky procesverbal duhet të miratohet.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.*

## **3. Miratimi i procesverbalit të dëgjimit publik lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e dëgjimit publik lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi, pa vërejtje.*

## **4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të grupit të punës lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi**

**Sadik Idriz** – E ftoi raportuesen e grupit të punës ta njoftonte Komisionin për punën e grupit të punës, deri ku ka arritur ky grup me përgatitjen e raportit me rekomandime.

**Qamile Morina** – Tha se gjatë monitorimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi, vazhdimisht janë paraqitur disa pengesa dhe vonesa. Pas dëgjimit publik grupi i punës ka caktuar takim për 16 shkurt 2009, mirëpo ky takim është shtyrë për 20 shkurt 2009, sepse 16 shkurti ishte ditë pushimi. Po ashtu takimi i planifikuar për 20 shkurt është shtyrë për 23 shkurt 2009, për arsye shëndetësore të raportueses. Takimi i grupit të punës është mbajtur më 23 shkurt 2009 dhe në atë takim kanë marrë pjesë vetëm dy anëtarë të këtij grupi të punës. Meqenëse grupi i punës përbëhet nga pesë anëtarë, në takimin e kaluar nuk kemi arritur ta bëjmë raportin me rekomandime. Ftoj anëtarët e grupit të punës që takimi i radhës të mbahet në një nga ditët e ardhshme të përshtatshme për të gjithë anëtarët e grupit. Gjatë përgatitjes së raportit është paraqitur nevoja për disa sqarime shtesë, për disa dokumente shtesë, për të cilat në të njëjtën ditë është bërë kërkesa në Ministrinë e Shëndetësisë. Besoj se në mbledhjen e radhës do të dalim me një raport përfundimtar që do të procedohet në seancë plenare.

**Gjylnaze Syla** – Tha se grupi i punës ka pasur nevojë edhe për disa dokumente shtesë. Grupi i punës në mbledhjen e kaluar e shqyrtoi nen për nen Ligjin për veprimtarinë private në shëndetësi, për të konstatuar nëse ato nene janë zbatuar në praktikë ose jo. Kornizat bazë janë përgatitur, por është e nevojshme që grupi i punës të pajtohet për ato rekomandime, për të cilat pastaj do të vendosë Komisioni.

**Mimoza Ahmetaj** – Tha se takimet e grupit të punës janë anuluar disa herë. Nëse grupi i punës pajohet për datën e mbajtjes së takimeve, të mos anulohen takimet, sepse anëtarët e këtij grupi kanë të planifikuara edhe takime të tjera.

**Teuta Hadri** – Tha, kur caktohet rendi i ditës, duhet edhe të organizohet puna, sepse jemi njerëz që kemi obligime. Nuk është mirë të kemi këso pikash të rendit të ditës.

**Armend Zemaj** – Tha se në ditën e takimit të grupit të punës ka qenë në Tiranë dhe e ka lënë

porosinë që ai i mbështet të gjitha rekomandimet që dalin nga takimi i grupit të punës.

*Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni nxori këtë*

### *Përfundim*

*Grupi i punës për përgatitjen e raportit me rekomandime lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi, do të takohet të hënën, më 02 mars 2009, në orën 09:00.*

## **5. Të ndryshme**

### **a) Diskutim rreth propozimit për vizitën e anëtarëve të Komisionit në FSSHK**

**Rita Hajzeraj** – Propozoi që një grup i anëtarëve të Komisionit ta vizitojë Federatën Sindikale të Shëndetësisë, meqenëse punëtorët shëndetësorë janë në protestë, në mënyrë që të shohim se cilat janë kërkesat e tyre.

**Mimoza Ahmetaj** – Tha se punëtorët shëndetësorë, të cilët kanë paralajmëruar protestën, kanë arritur një marrëveshje.

**Nurishahe Hulaj** – Tha se punëtorët shëndetësorë nuk janë në protestë, por janë në grevë. Kam marrë një material, në të cilin thuhet se është arritur marrëveshja për pagesën e shujtës, për nivelin dytësorë dhe tretësor. Është duke u biseduar edhe me komunat, dhe se disa prej tyre janë në realizim e sipër të kësaj marrëveshjeje.

### **b) Njoftim lidhur me Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës**

**Sadik Idriz** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në Kuvend është proceduar Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës. Në mbledhjen e radhës Komisioni do të ketë në rend dite shqyrtimin e këtij Projektligji para miratimit në parim. Gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji ne duhet të kemi parasysh që ende nuk kemi ligjin e punës.

**Gjylnaze Syla** – Lidhur me Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Kosovë, tha se nuk mund të punojmë në këtë Projektligj, sepse ne nuk e kemi ligjin bazik për këtë çështje. Me ligjin bazë nuk është definuar se cili konsiderohet punëtor publik dhe cili punëtor privat. Pa u definuar statusi i punëtorëve vendorë, si mund të definohet statusi i punëtorëve të huaj. Lidhur me këtë duhet t'i bëhet e qartë Qeverisë, se nuk ka politikë të qartë në këtë drejtim.

### **c) Diskutim rreth propozimit për ta ftuar në takim inspektorin farmaceutik**

**Teuta Hadri** – Propozoi që Komisioni ta ftojë për ta dëgjuar inspektorin farmaceutik, në mënyrë që Komisioni të informohet për barnat me afat të skaduar, që po qarkullojnë në Kosovë. Ne duhet të informohemi për këtë situatë që të dalim me një qëndrim për këtë çështje, sepse kjo është çështje me interes kombëtar.

**Gjylnaze Syla** – Tha se Komisioni duhet të merret më tepër me sektorin farmaceutik. Është koha që ky komision të merret me mbikëqyrjen e këtij sektori.

### **d) Diskutim për takimin me ministrin e Shëndetësisë dhe me ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale**

**Sadik Idriz** – Tha se Komisioni ka planifikuar t'i ftojë në takim ministrin e Shëndetësisë dhe

ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Ne do të diskutojmë lidhur me arsyen dhe me temat për takim.

**Mimoza Ahmetaj** – Tha: Bazë për takim me ministrat duhet të jenë ligjet e parapara për shqyrtim, por Komisioni nuk mund t'i ikë temës për gjendjen në shëndetësi.

#### **e) Diskutim për shkresën e punëtorëve të AKPM-së**

**Sadik Idriz** – Njoftoi anëtarët e Komisionit për shkresën e drejtuar Komisionit, nga punëtorët e AKPM-së. Komisioni nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar përmbajtjen e kësaj shkrese, por Komisioni duhet të jetë i informuar.

**Armend Zemaj** – Lidhur me shkresat që i drejtohen Komisionit, tha se ky komision duhet të nxjerrë rekomandim për ato shkresa - nuk duhet t'i injorojë ato. Në rastin konkret Komisioni duhet ta nxjerrë një rekomandim për Komisionin përkatës për këtë çështje - Komisionin për Peticione dhe Ankesa.

Komisioni ka shqyrtuar ankesën e Fabrikës “New Co- Farmakos” dhe propozoi që Komisioni ta nxjerrë një rekomandim konkret.

**Rita Hajzeraj** – Lidhur me çështjen e fabrikës “New Co- Farmakos”, tha se pajtohej me propozimin e deputetit Armend Zemaj. Përderisa janë dëgjuar të dyja palët, Komisioni ka për obligim të dalë me një rekomandim konkret për këtë çështje.

**Gjylanze Syla** – Tha se mundësitë e Komisionit në disa situata janë shumë të kufizuara, por Komisioni mund të luajë rol lehtësues për të marrë vendim. Para se ta japim një rekomandim, duhet ta marrim një informatë nga ministri se ku gjendet kjo situatë, nëse ka ndonjë vendim ose jo, lidhur me këtë çështje.

Sa i përket shkresës së punëtorëve të AKPM-së, tha është e dukshme se ka shkelje ligjesh, mirëpo kjo është çështje e gjykatave. Komisioni duhet ta marrë këtë si informatë, për ta mbikëqyrur këtë sektor.

**Qamile Morina** – Propozoi që para se të ftohet inspektori ose kushdo tjetër, t'u dërgohet kjo shkresë, në mënyrë që të vërtetohet saktësia e këtyre të dhënave në këtë shkresë, pastaj Komisioni të dalë me një rekomandim.

**Nurishahe Hulaj** – Tha se pas çdo shqyrtimi të shkresave Komisioni duhet të nxjerrë një rekomandim. Kjo ka qenë dhe është praktikë e mirë.

*Lidhur me shqyrtimin e shkresës së fabrikës “New Co-Farmakos”, pas diskutimeve të deputetëve, Komisionin nxori këtë*

#### *Rekomandim*

*Kompanisë për prodhimin e produkteve medicinale “New Co Farmakos” nga Prizreni, t'i vazhdohet licenca e punës për dy vjet, në mënyrë që brenda kësaj periudhe, kjo kompani t'i plotësojë kushtet e parapara me ligj dhe me akte nënligjore .*

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

*E përgatiti:*

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz